



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1003/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit E... Q... me seli në Vushtri kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.3124/19 të datës 01.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.12.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit E... Q... me seli në Vushtri, e ushtruar me datën 26.08.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.3124/19 të datës 01.07.2021, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.3124/19 të datës 01.07.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit E... Q... me seli në Vushtri, dhe ka mbet në fuqi Vendimi i të paditures Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë-Departamenti i Ankesave nr.515/2019 dt.09.12.2019.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, vërtetimit të egabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të prishet aktgjykimi A.nr.3124/19 të datës 01.07.2021, ashtu që lënda ti kthehet gjykatës së njëjtë në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e Shkallës së parë nuk ka marrë për bazë faktet mbi të cilat është bazuar padia e si rezultat i shkeljeve të tilla konsiderojmë që ka nxjerr një aktgjykim jo të bazuar juridikisht dhe të pa vërtetuar faktikisht. Aktvendimi i atakuar me ankesë përmban shkelje nga neni 182 pika (n), për faktin se nuk mund të ekzaminohet, është i pakuptueshëm kontradiktor me vetveten dhe arsyet e dhëna në aktvendim janë të paqarta. Gjendja e krijuar rreth këtij biznesi që ka qenë i pasivizuar edhe me vet fajin e ATK-së, sepse kur një biznes pasivizohet atëherë si ka mundësi që të ndëshkohet dhe ngarkohet me përgjegjësi financiare. Vërtetimi o gabuar dhe jo i

plotë i gjendjes faktike vjen në shprehje kur gjykata aktvendimin e vet e mbështet në kinse ikjen e afatit për ankes, e në fakt afati ka qenë 30 ditë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.515/2019 të datës 09.12.2019, ka Hedhur poshtë sit ë pas afatshme ankesën e padiësit dhe ka vërtetuar sit ë bazuar vendimin nr.503/2019 të lëshuar nbgja Zgjona. Padiësi ndaj këtij vendimi të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi në gjykatë, me të cilën ka inicuar konflikt administrativ respektivisht ka kundërshtuar ligjshmërin e vendimit nr.515/2019 të datës 09.12.2019 të paditures ATK-së, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm, duke i propozuar gjykatës ta anuloj vendimin e kundërshtuar me padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së padiësit paraqitur kundër vendimit përfundimtar në procedurën administrative të nxjerr nga e paditura Administrata Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 01.07.2021, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e padiësit e refuzon si të pa bazuar. Në arsyetim të akgjykimit ankimor, gjykata e shkallës së parë thekson se padiësi as para të paditures dhe as në gjykat nuk ka mund të dëshmoj ndonjë rrethanë që e ka penguar për ushtrimin e ankesës tek e paditura brenda afatit ligjor, gjykata në bazë të provave të administruara vendimit kontestues, deklarimeve në ankes nga padiësi ka vlersuar se padiësi ka ushtruar ankes tek e paditura jashtë afatit ligjor në Departamentin e Ankesave, për arsye se vendimin e të paditures, padiësi e ka pranuar me datën 03.10.2019 dhe ankesën e ka parashtruar me datë 07.11.2019. Gjykata vendimin e ka mbështet në dispozitat e nenit 77 parag 2 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 44 parag.6 pika 1,2 dhe 3 e U.A. 15/2010, ku afati për paraqitjen e ankesës është 30 ditë pas pranimit të përcaktimit zyrtar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave procedurale apo ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kolegji konstaton, se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e padiësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave kontestimore nga neni 182 pika (n) e LPK-së, këto pretendime ankimore Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, meqë aktgjykimi ankimor është i qartë dhe i përmban faktet vendimtare në bazë të cilave është konfirmuar vendimi i të paditures, se ankesa e paraqitur pranë të paditures Departamenti i Ankesave i ATK-së, është paraqit jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, që parashihet me nenin 77.2 të

Ligjit nr.03/L-202 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenin 44 paragrafi 6 pika 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. Kolegji gjithashtu nuk ka gjetur se ekzistojnë shkelje të dispozitave procedurale të cilat do të kishin ndikim në marrjen e vendimit kontestues të paditues nr.515/2019 dt.09.12.2019.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera ankimore lidhur me afatin e ankesës së paraqitur tek e paditura, Kolegji, i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, si dhe janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është refuzuar kërkespadija e paditësit, për arsye se e paditura ka aplikuar drejt legjislacionin tatimor në këtë rast nenin 77 të Ligjit 03/L-202 dhe nenin 44 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, kur e ka hudhur poshtë ankesën e paditësit si të pas afatshme, pasi që paditësi e ka pranuar vendimin e organit faktit të paditues me datën 03.10.2019, ndërsa ankesën e ka parashtruar pranë Departamentit të Ankesave me datën 07.11.2019. Kolegji vlerësoi se në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar me të drejtë gjendjen faktike, se paditësi nuk ka paraqit asnjë provë për të dëshmuar se ka paraqitur ankesën brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1003/22 datë 15.12.2022

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha